



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1658/ Prot.
11

Tiranë, më 08.09 2026

V E N D I M

Nr. 116 dt. 08.09 2026

“PËR
NDRYSHIMIN E NENIT 12 TË RREGULLORES SË ORGANIZIMIT TË
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3, 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr. 57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 28 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, nenet 6,7 dhe 9 të Rregullores së organizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë “doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në shkresën e Rektorit me nr. 1641 prot., datë 03.09.2026 “Relacion mbi propozimin për ndryshimin e nenit 12 “bashkëudhëheqja” të Rregullores së Organizimit të Programeve të Studimit të Ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Vendimin e Rektoratit nr.106, datë 04.09.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.09.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 12 “Bashkëudhëheqja” të Rregullores së Organizimit të Programeve të Ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Ishte:

Neni 12
Bashkëudhëheqja

1. Bashkëudhëheqja konsiderohet një formë bashkëpunimi akademik, ku një doktorant udhëhiqet nga 2 (dy) anëtarë të personelit akademik të kategorisë “Profesor”.
2. Doktoranti dhe udhëheqësi mund t’i drejtojnë me shkrim njësisë bazë kërkesën e arsyetuar për bashkëudhëheqje brenda UST-së, në rastet kur identifikohet nevoja për zgjerim të fushës së kërkimit, ose ekspertizë e specializuar në një aspekt të caktuar që mbështet kërkimin e doktoratës.

3. Njësia bazë shqyrton kërkesën, jep një mendim të arsyetuar dhe merr vendim për miratim ose refuzim me shumicë të thjeshtë votash. Vendimi i njësisë bazë i përcillet njësisë kryesore (Fakultetit). Drejtuesi i njësisë kryesore, ja përcjellë rektorit. Pas shqyrtimit të kërkesës, ky i fundit merr vendimin përfundimtar lidhur me pranimin ose jo të kërkesës për bashkëudhëheqje brenda UST-së. Rektori vazhdon procedurat për miratimin në Ministrinë përgjegjëse dhe regjistrimin e bashkëudhëheqjes në QSHA. Pas miratimit nga Ministria përgjegjëse dhe regjistrimit në QSHA, bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e njësisë kryesore për regjistrimin e bashkëudhëheqjes.
4. Për efekt të plotësimit të kriterëve për marrjen e titullit "Profesor", bashkëudhëheqësi duhet të jetë angazhuar, të paktën dy vite të punës së doktorantit, para dorëzimit të disertacionit, dhe për këtë periudhë të ketë marrë miratimin si kapacitet akademik nga ministri përgjegjës për arsimin (sipas kuadrit ligjor në fuqi).
5. Në rastet kur personeli akademik i UST-së do të angazhohet në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, dokumentacioni që duhet të dorëzohet pranë njësisë bazë ku është i angazhuar, me qëllim fillimin e procedurave për marrjen e dakordësisë/miratimit nga institucioni, është si më poshtë:
 Staf i akademik i kategorisë "Profesor" dorëzon kërkesën për shqyrtim dhe lejim të angazhimit si udhëheqës shkencor në IAL tjetër, pranë njësisë së tij bazë.
 Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna mbi:
 - a. Titullin e projektit kërkimor shkencor;
 - b. Fusha kërkimore në të cilën do të përfshihet si bashkëudhëheqës;
 - c. Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit ku do të angazhohet personeli akademik në bashkëudhëheqje.
 - d. Vendimi i IAL-së ku do të kryhet bashkëudhëheqja, i cili e pranon si udhëheqës shkencor.
6. Njësia bazë shqyrton kërkesën, jep një mendim të arsyetuar dhe merr vendim për miratim ose refuzim me shumicë të thjeshtë votash. Vendimi i njësisë bazë i përcillet njësisë kryesore (Fakultetit). Drejtuesi i njësisë kryesore, ja përcjellë Rektorit.
7. Rektori i UST-së jep vendimin përfundimtar për angazhimin e personelit akademik në bashkëudhëheqje pranë IAL-së tjetër dhe e përcjell vendimin pranë njësisë kryesore.
8. Për të gjitha rastet e kërkesës së angazhimit të personelit akademik në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UST-së dhe IAL-së përkatës.
9. Në rastet kur personeli akademik i një IAL-je tjetër do të angazhohet në bashkëudhëheqje në UST ose njësia bazë/kryesore e UST-së shpreh interes për bashkëpunim me individë/njësi të IAL-ve të tjera procedura e këtij bashkëpunimi është si më poshtë vijon:
 Personeli akademik i një IAL-je tjetër përcjell kërkesën për bashkëudhëheqje pranë njësisë bazë të UST-së së bashku me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Titulli i projektit kërkimor/shkencor ku kërkohet bashkëpunimi/bashkëudhëheqja.

- b. Fusha kërkimore ku kërkohet përfshirja e personelit akademik ose njësisë bazë nga IAL e tjera.
 - c. Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit partner.
 - d. Arsyetimi shkencor mbi nevojën e bashkëpunimit/bashkëudhëheqjes dhe përfitimet për UST.
 - e. Kapaciteti shkencor dhe infrastrukturor që ofron njësia bazë/personeli akademik i IAL-së tjetër.
 - f. Leja e drejtuesit të IAL-së për të kërkuar bashkëpunimin.
10. Njësia bazë shqyrton kërkesën, jep një mendim të arsyetuar dhe merr vendim për miratim ose refuzim me shumicë të thjeshtë votash. Vendimi i njësisë bazë i përcillet njësisë kryesore (Fakultetit). Drejtuesi i njësisë kryesore, ja përcjellë rektorit.
 11. Rektori i UST-së merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e angazhimit të personelit akademik të IAL-së tjetër si bashkëudhëheqës pranë UST-së.
 12. Për të gjitha rastet, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UST-së dhe IAL-së përkatës.
 13. Një marrëveshje e posaçme nënshkruhet midis Rektorit të UST-së dhe personelit akademik të njësisë bazë të IAL-së me të cilën do të bashkëpunohet.
 14. Në rast bashkëpunimi mes dy njësive bazë nga dy IAL të ndryshme, një nga UST dhe një nga IAL tjetër, marrëveshja e posaçme nënshkruhet midis dy rektorëve përkatës.
 15. Personeli akademik i IAL-së tjetër merr statusin e personelit akademik të jashtëm gjatë kohës së bashkëpunimit, sipas kushteve të rregulluara nga marrëveshjet përkatëse.
 16. Kushtet, koha dhe pagesa mbi përqindjen e orëve të punës që bashkëudhëheqësit ndajnë mes tyre, të llogaritura këto mbi numrin maksimal të orëve që legjislacioni në fuqi parashikon për udhëheqjen e një doktoranti, specifikohen në marrëveshjen e posaçme.
 17. Pronësia intelektuale mbi produktet shkencore të prodhuara nga ky bashkëpunim, i takon UST-së.

Bëhet:

Neni 12

Bashkëudhëheqja

1. Bashkëudhëheqja konsiderohet një formë bashkëpunimi akademik, ku një doktorant udhëhiqet nga dy (2) anëtarë të personelit akademik të kategorisë "Profesor" të cilët kontribuojnë në mënyrë të koordinuar në drejtimin shkencor të punimit të doktoratës..
2. Doktoranti dhe udhëheqësi shkencor mund t'i drejtojnë me shkrim njësisë bazë një kërkesë të arsyetuar për bashkëudhëheqje brenda UST-së, në rastet kur identifikohet nevoja për zgjerim të fushës së kërkimit ose për ekspertizë të specializuar në një aspekt të caktuar që mbështet kërkimin e doktoratës.
3. Kërkesa për bashkëudhëheqje duhet të përmbajë:

- a) arsyetimin shkencor mbi nevojën për bashkëudhëheqje;
 - b) fushën e kërkimit në të cilën do të angazhohet bashkëudhëheqësi;
 - c) të dhënat dhe dokumentacionin përkatës të bashkëudhëheqësit të propozuar;
 - ç) dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve ligjore dhe institucionale për ushtrimin e funksionit të bashkëudhëheqësit.
4. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
 5. Komisioni për dhënien e gradës shkencore "Doktor" shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.
 6. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.
 7. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.
 8. Rektori, mbi bazën e vendimit të Senatit, përcjell dokumentacionin pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe siguron kryerjen e procedurave administrative për regjistrimin e bashkëudhëheqjes në QSHA.
 9. Pas miratimit dhe regjistrimit, bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e njësisë kryesore.
 10. Për efekt të plotësimit të kriterëve për marrjen e titullit "Profesor", bashkëudhëheqësi duhet të jetë angazhuar të paktën dy (2) vite të punës së doktorantit, para dorëzimit të disertacionit, dhe për këtë periudhë të ketë marrë miratimin si kapacitet akademik nga ministri përgjegjës për arsimin, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
 11. Në rastet kur personeli akademik i UST-së do të angazhohet në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, personeli akademik i kategorisë "Profesor" paraqet pranë njësisë bazë kërkesën për shqyrtim dhe lejim të angazhimit si bashkëudhëheqës, së bashku me dokumentacionin përkatës.
 12. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna mbi:
 - e. Titullin e projektit kërkimor shkencor;
 - f. Fusha kërkimore në të cilën do të përfshihet si bashkëudhëheqës;
 - g. Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit ku do të angazhohet personeli akademik në bashkëudhëheqje.

- h. Vendimi i IAL-së ku do të kryhet bashkëudhëheqja, i cili e pranon si udhëheqës shkencor.*
- 13. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor".*
- 14. Komisioni për dhënien e gradës shkencore "Doktor" shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.*
- 15. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.*
- 16. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.*
- 17. Për të gjitha rastet e angazhimit të personelit akademik të UST-së në bashkëudhëheqje pranë institucioneve të tjera të arsimit të lartë, duhet të ketë një marrëveshje paraprake bashkëpunimi ndërmjet UST-së dhe IAL-së përkatës, në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme në fuqi.*
- 18. Në rastet kur personeli akademik i një IAL-je tjetër do të angazhohet në bashkëudhëheqje në UST, ose kur njësia bazë apo njësia kryesore e UST-së shpreh interes për bashkëpunim me individë apo njësi të IAL-ve të tjera, procedura e bashkëpunimit është si më poshtë vijon:*

Personeli akademik i një IAL-je tjetër përcjell kërkesën për bashkëudhëheqje pranë njësisë bazë të UST-së së bashku me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Titulli i projektit kërkimor/shkencor ku kërkohet bashkëpunimi/bashkëudhëheqja.*
 - b) Fusha kërkimore ku kërkohet përfshirja e personelit akademik ose njësisë bazë nga IAL e tjera.*
 - c) Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit partner.*
 - d) Arsyeimi shkencor mbi nevojën e bashkëpunimit/bashkëudhëheqjes dhe përfitimet për UST.*
 - e) Kapaciteti shkencor dhe infrastrukturore që ofron njësia bazë/personeli akademik i IAL-së tjetër.*
 - f) Miratimin e drejtuesit të IAL-së tjetër për të kërkuar bashkëpunimin.*
- 19. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të*

propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor".

20. Komisioni për dhënien e gradës shkencore "Doktor" shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.
 21. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.
 22. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.
 23. Për të gjitha rastet, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UST-së dhe IAL-së përkatës.
 24. Përpara fillimit të angazhimit lidhet një marrëveshje e posaçme ndërmjet UST-së dhe personelit akademik të IAL-së tjetër, ku përcaktohen objekti, kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe kushtet e angazhimit.
 25. Në rast bashkëpunimi mes dy njësive bazë nga dy IAL të ndryshme, një nga UST dhe një nga IAL tjetër, marrëveshja e posaçme nënshkruhet midis dy rektorëve përkatës.
 26. Personeli akademik i IAL-së tjetër merr statusin e personelit akademik të jashtëm gjatë periudhës së bashkëpunimit, sipas kushteve të rregulluara nga marrëveshjet përkatëse.
 27. Kushtet e angazhimit, kohëzgjatja dhe pagesa, përfshirë ndarjen e ngarkesës ndërmjet bashkëudhëheqësve, përcaktohen në marrëveshjen e posaçme, duke respektuar kufijtë e ngarkesës dhe të pagesës të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e UST-së.
 28. Të drejtat mbi pronësinë intelektuale të produkteve shkencore të krijuara në kuadër të bashkëpunimit përcaktohen në marrëveshjen përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronësinë intelektuale dhe me kontributin e palëve në krijimin e tyre.
2. Ky vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”
NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.30 datë 23.02.2026 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, i ndryshuar me Vendim Senati Nr. 49, datë 03.04.2026, Vendim Senati Nr. 62, datë 21.04.2026 dhe Vendim Senati nr.116, datë 08.09.2026

Tiranë, Shtator 2026

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë/kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtaritë e lidhura me këto programe studimi.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, (këtu e në vazhdim Ligji nr.80/2015) si dhe në aktet nënligjore, dalë në bazë dhe për zbatim të tij, sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Objektivat e programeve të studimit të Doktoratës

Programet e studimit të doktoratës, janë studime të ciklit të tretë të formimit universitar në zbatim të pikës 1 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 80/2015, në përfundim të të cilave lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

Objektivat e këtyre programeve të studimit janë:

1. Programet e studimit të doktoratës në UST synojnë nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat/nënfushat kërkimore që studiohen në UST, orientimin drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe integritetit të njohurive e rezultateve të kërkimit dhe sjelljen e risive në kërkimin e mendimin shkencor.
2. Programet e studimit të doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor të pavarur, si bazë për hulumtimin, përfundimin e rezultateve e risive në fushë, që lidhen me projektet kërkimore të njësisë bazë/kryesore e që shërbejnë si bazë për përgatitjen e disertacionit të doktoratës, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Neni 4

Struktura që ofron programet e doktoraturës në UST dhe kohëzgjatja

1. Programet e studimit të doktoratës mund të ofrohen nga njësitë bazë, grupime të njësive bazë ose në bashkëpunim me struktura kërkimore vendase ose të huaja bazuar në marrëveshjet përkatëse.

2. Programet e studimit të doktoratës, ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat/nënfushat e përcaktuara nga njësia bazë. Ato zhvillohen në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit në njësitë bazë, kryesore dhe atyre ndërfakultetore të UST-së.
3. Këto studime zgjasin 3 – 5 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

KREU II

ORGANET DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR DREJTIMIN DHE MBARËVAJTJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS

Neni 5

Strukturat përgjegjëse

Organet dhe autoritetet përgjegjëse për drejtimin dhe mbarëvatjen e programeve të studimit të ciklit të tretë të Doktoratës në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë:

1. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;
2. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”;
3. Drejtuesi i Njesisë Kryesore/Departamentit përgjegjës për programin/programet e studimit të Doktoratës;
4. Koordinatori i programit të studimit të Doktoratës;
5. Udhëheqësi shkencor i kandidatit;
6. Sekretariati i dokumentacionit.

Neni 6

Drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të Doktoratës

Janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të ciklit të tretë të Doktoratës:

1. Njësitë bazë dhe njësitë kryesore të UST-së. Kur programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, përcaktohen në bashkëpunim të njësive bazë me njëra-tjetrën sipas marrëveshjeve të hartuara prej tyre. Në rast të programeve që përfshijnë më shumë se një njësi bazë, njëra prej njësive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre. Njësitë bazë mund të mbështeten edhe nga qendrat kërkimore-shkencore për realizimin e programit të doktoratës.
2. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” i cili është përgjegjës për monitorimin e procesit, ngritjen e jurisë për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” dhe marrjen e vendimit përfundimtar për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

3. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” vlerëson disertacionin e kandidatit për gradën shkencore “Doktor” dhe mbrojtjen e tij.

Neni 7

Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor i Shkencave”(KPD)

1. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është komision i përhershëm që ngrihet në nivel të njëjësive kryesore. Komisioni në nivel njësie kryesore ka në përbërje jo më pak se 5 (pesë) anëtarë.
2. Anëtarët e Komisionit zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e asamblesë së personelit akademik. Anëtarët duhet ti përkasin kategorisë “Profesor”.
3. Anëtarësia në Komisionin e Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor” është e papajtueshme me funksionet e Drejtuesit të Departamentit Përgjegjës për programin/programet e Studimit të Doktoratës, dhe të Koordinatorit të Programit të Doktoratës.
4. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është përgjegjës për monitorimin e procesit dhe dhënies së gradës shkencore “Doktor” dhe vendimmarrje sipas parashikimeve në këtë rregullore dhe atë të KPD-së.
5. Komisioni monitoron procesin e pranimeve dhe ecurinë e kandidatëve të regjistruar në programin e studimit, por pa ndërhyrë në përgjegjësitë e njësisë bazë dhe kryesore.
6. Komisioni shqyrton ankimime dhe/ose parregullsi të procesit që evidentohen dhe/ose nuk gjejnë zgjidhje nga njësia bazë/kryesore përgjegjëse për programin e studimit.
7. Komisioni mund të ndërhyjë në procedura të procesit (si pranime, vlerësim në faza të caktuara, përpara mbrojtjes) apo çështje të tjera si pezullimi, anulimi, ndryshimi të elementeve të temës së kërkimit (nuk ndryshojnë përmbajtjen kryesore), ndryshim i udhëheqësit shkencor dhe për të garantuar përmbushjen e kriterëve e procedurave të kërkuara duke garantuar përputhshmërinë me kuadrin ligjor e rregullativ si dhe integritetin e procesit.
8. Komisioni mund të dërgojë përfaqësuesit e tij në takimet që zhvillohen me kandidatët, në referimet e kandidatëve gjatë ecurisë së studimeve dhe përpara mbrojtjes së dizertacionit.
9. Komisioni verifikon dosjen e kandidatit dhe vlerëson përputhshmërinë me kriteret përpara mbrojtjes së dizertacionit, pas procesit të kryer në njësinë bazë.
10. Komisioni përcakton dhe zgjedh Jurinë për mbrojtjen e dizertacionit kur vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe në këtë rregullore.
11. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të Jurisë.
12. Në rast të konfliktit të interesit i referohemi nenit 68 të Statutit të UST-së.
13. Procedurat e funksionimit përcaktohet në rregulloren e Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.

Neni 8

Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”

1. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” ngrihet nga Komisioni i Përhershëm i dhënies së gradës shkencore “Doktor” të njësisë kryesore sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë rregullore.
2. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” ngrihet mbi bazën e një liste prej jo më pak se 8 (tetë) anëtarësh, të propozuar nga njësi bazë në bashkëpunim me udhëheqësin dhe kandidatin, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore, dhe i përcillet Komisionit të Përhershëm të Doktoraturës. Lista përbëhet nga 8 (tetë) anëtarë, prej të cilëve 3 (tre) janë anëtarë të jashtëm të IAL-së (në mungesë, nga një njësi kryesore tjetër) dhe 5 (pesë) janë anëtarë të brendshëm të njësisë kryesore.
Nga kjo listë për zgjidhet juria prej 5 (pesë) anëtarësh për mbrojtjen e disertacionit. Së paku 2 (dy) anëtarë të juriës duhet t’i përkasin njësi bazë të institucioneve homologe, vendase ose të huaja. Dy anëtarë të juriës caktohen si oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve duhet të jetë nga një njësi bazë e një institucioni homolog, vendas ose të huaj.
3. Anëtarët e juriës i përkasin kategorisë “Profesor” të fushës që mbulon studimi i doktoratës dhe së paku njëri prej tyre me gradën PHD ose më shumë nga një institucion i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës.
4. Juria ka këto funksione:
 - a) administron procesin e mbrojtjes së disertacionit të kandidatit sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë rregullore;
 - b) bën vlerësimin e kandidatit në përfundim të procesit të mbrojtjes;
 - c) harton raportin përfundimtar të vlerësimit të kandidatit dhe ja përcjell atë Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor” për vendimmarrje;
5. Procedura që ndiqet për procesin e mbrojtjes parashikohet në vijim në këtë rregullore.
6. Procedurat e funksionimit të Juriës përcaktohet në rregulloren e Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.

Neni 9

Përgjegjësitë e Njesisë bazë

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.
2. Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës përcakton kriteret e aplikimit, lidhur me gjuhën /gjuhët e huaja, mesataren e pranimit, fushën e studimit dhe programet e studimit të cilët pranohen si kandidatë, dokumentët e aplikimit etj. dhe i bën ato publike.
3. Njësia bazë, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të njësisë kryesore përkatëse, përcakton dhe propozon fushat/nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës, të cilat më pas miratohen sipas parashikimeve në vijim në këtë rregullore.
4. Njësia bazë përcakton kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve doktorantë sipas fushave

- e nënfushave të përcaktuara në cdo thirrje për pranim në këto programe.
5. Njësia bazë propozon komisionin Ad-Hoc i cili shqyrton dhe vlerëson dosjet e aplikantëve dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e doktoratës që mbulon.
 6. Njësia bazë propozon udhëheqësit shkencorë të doktoratës, në bashkëpunim me Dekanatin e njësisë kryesore, dhe miratohen nga Senati Akademik.
 7. Njësia bazë ka përgjegjësi t'u sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
 8. Njësia bazë ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
 9. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecursisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët, nëse konstatohen probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.
 10. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
 11. Për çështje të tjera, njësia bazë i drejtohet për vendimmarrje autoriteteve/organeve të tjera sipas parashikimeve në vijim në këtë rregullore.
 12. Njësia bazë ka përgjegjësi për ofrimin e cilësisë duke ju përshtatur standarteve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Neni 10

Përgjegjësitë e koordinatorit shkencor të programit të studimit

Programi i studimit të Doktoratës, në nivel të njësisë bazë ndiqet e koordinohet nga koordinatori i programit të studimit të Doktoratës, që ndërmjet anëtarëve me titull akademik të kategorisë "Profesor". Njësia bazë i propozon njësisë kryesore për miratim kandidatin/ët të kategorisë "Profesor". Mandati i koordinatorit të programit të studimit është 4 vjeçar.

Koordinatori ka këto përgjegjësi:

1. Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqës shkencorë sipas rregullave për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
2. Të interesohet për t'u siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme.
3. Të garantojë se janë respektuar politikat e udhëheqjes.
4. Të garantojë se për zhvillimin e doktoratës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore.
5. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon njësisë bazë ndryshimet e nevojshme.
6. Të garantojë se procedura e mbikqyrjes dhe e shqyrtimit të ecursisë së kërkimit është e rregullt.
7. T'i njohë studentët me të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj, që kanë të bëjnë më procesin e fitimit të gradës shkencore.

8. Koordinator informon njësinë bazë dhe Komisionin e Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor” mbi ecurinë e programit të studimit, raportet vjetore, ecurisë dhe çështje të tjera të parashikuara në vijim në këtë rregullore.

Neni 11

Udhëheqësi shkencor

1. Udhëheqësit shkencorë të kandidatëve që ndjekin studimet në programet e ciklit të tretë “Doktoratë” i përkasin kategorisë “Profesor”.
2. Udhëheqësit që i përkasin kategorisë “Profesor” kanë të drejtë të udhëheqin kandidatë sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për programet e njësisë bazë, të përbashkëta ose ndërdisiplinore të Doktoratës, mund të caktohen dy udhëheqës për drejtimin e kandidatëve, një nga secila njësi bashkëpunuese.
4. Kriteret për përzgjedhjen dhe caktimin e udhëheqësve shkencorë:
 - a. Udhëheqësi shkencor duhet ti përkasë të njëjtës fushë kërkimore dhe specifike (nënfushës) të projektit të doktoratës.
 - b. Udhëheqësi shkencor duhet të ketë përvojë mësimdhënëse e botime shkencore në fushën e projektit të doktoratës që udhëheq.
 - c. Udhëheqësit shkencorë që janë personel akademik në institucione të tjera të arsimit të lartë me të cilët UST ka marrëveshje bashkëpunimi, përzgjidhen/miratohen ata që janë specialistë të fushës së përgjithshme e specifike të doktoratës e për ato projekte që janë me përmbajtje ndërdisiplinore por të zbatuara në fushat e aktivitetit fizik dhe sportit.
 - d. Udhëheqësi/it shkencor sipas pikës c, duhet të përfshihet në listat e kapaacitetet pritëse të njësisë të IALs-së.
5. Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor janë:
 - a. Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor gjatë udhëheqjes së doktoratës.
 - b. Të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e dizertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore.
 - c. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndër të tjera dhe orientim në lidhje me:
 - i. Formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit.
 - ii. Rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit.
 - iii. Konsulencë të vazhdueshme për realizimin e kërkimit, publikimeve dhe përmbajtjen e dizertacionit.
 - d. Udhëheqësi duhet të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor.
 - e. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht (takime të rregullta) duke i kërkuar atij të

- paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është në standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- f. Të nxisë dhe mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj shkencore dhe prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe të sigurojë që ato janë në përmbushje të kriterëve të përcaktuara.
 - g. Udhëheqësi ka përgjegjësi të informojë, udhëzojë dhe ndërgjegjësojë studentin për rrezikun dhe shmangjen e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
 - h. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e njësise bazë mbas çdo raportimi dhe gjithashtu kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.
 - i. Të paraqesë shqetësime apo parregullsi mbi ecurinë e kandidatit, mosplotësimin e detyrimeve dhe të propozojë masat sipas natyrës së tyre.
 - j. Në rastet e bashkëudhëheqjes, udhëheqësit duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e tyre dhe të mbajnë kontakte të rregullta.
 - k. Udhëheqësi shkencor garanton plotësimin e të gjitha vërejtjeve dhe rekomandive të jurisë kur dizetacioni rikthehet për plotësime.

Neni 12

Bashkëudhëheqja

1. Bashkëudhëheqja konsiderohet një formë bashkëpunimi akademik, ku një doktorant udhëhiqet nga dy (2) anëtarë të personelit akademik të kategorisë “Profesor” të cilët kontribuojnë në mënyrë të koordinuar në drejtimin shkencor të punimit të doktoratës..
2. Doktoranti dhe udhëheqësi shkencor mund t’i drejtojnë me shkrim njësisë bazë një kërkesë të arsyetuar për bashkëudhëheqje brenda UST-së, në rastet kur identifikohet nevoja për zgjerim të fushës së kërkimit ose për ekspertizë të specializuar në një aspekt të caktuar që mbështet kërkimin e doktoratës.
3. Kërkesa për bashkëudhëheqje duhet të përmbajë:
 - a) arsyetimin shkencor mbi nevojën për bashkëudhëheqje;
 - b) fushën e kërkimit në të cilën do të angazhohet bashkëudhëheqësi;
 - c) të dhënat dhe dokumentacionin përkatës të bashkëudhëheqësit të propozuar;
 - ç) dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve ligjore dhe institucionale për ushtrimin e funksionit të bashkëudhëheqësit.
4. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij

në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

5. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.
6. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.
7. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.
8. Rektori, mbi bazën e vendimit të Senatit, përcjell dokumentacionin pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe siguron kryerjen e procedurave administrative për regjistrimin e bashkëudhëheqjes në QSHA.
9. Pas miratimit dhe regjistrimit, bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e njësisë kryesore.
10. Për efekt të plotësimit të kriterëve për marrjen e titullit “Profesor”, bashkëudhëheqësi duhet të jetë angazhuar të paktën dy (2) vite të punës së doktorantit, para dorëzimit të disertacionit, dhe për këtë periudhë të ketë marrë miratimin si kapacitet akademik nga ministri përgjegjës për arsimin, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
11. Në rastet kur personeli akademik i UST-së do të angazhohet në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, personeli akademik i kategorisë “Profesor” paraqet pranë njësisë bazë kërkesën për shqyrtim dhe lejm të angazhimit si bashkëudhëheqës, së bashku me dokumentacionin përkatës.
12. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna mbi:
 - a. Titullin e projektit kërkimor shkencor;
 - b. Fusha kërkimore në të cilën do të përfshihet si bashkëudhëheqës;
 - c. Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit ku do të angazhohet personeli akademik në bashkëudhëheqje.
 - d. Vendimi i IAL-së ku do të kryhet bashkëudhëheqja, i cili e pranon si udhëheqës shkencor.
13. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin

përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

14. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.
15. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.
16. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.
17. Për të gjitha rastet e angazhimit të personelit akademik të UST-së në bashkëudhëheqje pranë institucioneve të tjera të arsimit të lartë, duhet të ketë një marrëveshje paraprake bashkëpunimi ndërmjet UST-së dhe IAL-së përkatës, në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme në fuqi.
18. Në rastet kur personeli akademik i një IAL-je tjetër do të angazhohet në bashkëudhëheqje në UST, ose kur njësia bazë apo njësia kryesore e UST-së shpreh interes për bashkëpunim me individë apo njësi të IAL-ve të tjera, procedura e bashkëpunimit është si më poshtë vijon:

Personeli akademik i një IAL-je tjetër përcjell kërkesën për bashkëudhëheqje pranë njësisë bazë të UST-së së bashku me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Titulli i projektit kërkimor/shkencor ku kërkohet bashkëpunimi/bashkëudhëheqja.
 - b) Fusha kërkimore ku kërkohet përfshirja e personelit akademik ose njësisë bazë nga IAL e tjera.
 - c) Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit partner.
 - d) Arsytimi shkencor mbi nevojën e bashkëpunimit/bashkëudhëheqjes dhe përfitimet për UST.
 - e) Kapaciteti shkencor dhe infrastrukturore që ofron njësia bazë/personeli akademik i IAL-së tjetër.
 - f) Miratimin e drejtuesit të IAL-së tjetër për të kërkuar bashkëpunimin.
19. Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin për bashkëudhëheqjen dhe vlerëson nevojën shkencore për bashkëudhëheqje, lidhjen e fushës së ekspertizës së kandidatit të propozuar me temën dhe fushën e kërkimit të doktorantit, si dhe kontributin e pritshëm të tij në zhvillimin e projektit të doktoratës. Në përfundim të shqyrtimit, njësia bazë, me shumicë të thjeshtë votash, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës në aspektin e nevojës dhe përshtatshmërisë shkencore të bashkëudhëheqjes. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e njësisë bazë, i përcillet Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
 20. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe vendimin e njësisë bazë dhe verifikon përmbushjen e kritereve dhe procedurave të përcaktuara

- në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga kandidati i propozuar për bashkëudhëheqës. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni merr vendim dhe ia paraqet atë, së bashku me dokumentacionin përkatës, Senatit Akademik për shqyrtim dhe vendimmarrje.
21. Senati Akademik, pas shqyrtimit, merr vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e bashkëudhëheqjes.
 22. Vendimi i Senatit Akademik, së bashku me dokumentacionin përkatës, i përcillet Rektorit për vijimin e procedurave administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të UST-së.
 23. Për të gjitha rastet, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UST-së dhe IAL-së përkatës.
 24. Përpara fillimit të angazhimit lidhet një marrëveshje e posaçme ndërmjet UST-së dhe personelit akademik të IAL-së tjetër, ku përcaktohen objekti, kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe kushtet e angazhimit.
 25. Në rast bashkëpunimi mes dy njësive bazë nga dy IAL të ndryshme, një nga UST dhe një nga IAL tjetër, marrëveshja e posaçme nënshkruhet midis dy rektorëve përkatës.
 26. Personeli akademik i IAL-së tjetër merr statusin e personelit akademik të jashtëm gjatë periudhës së bashkëpunimit, sipas kushteve të rregulluara nga marrëveshjet përkatëse.
 27. Kushtet e angazhimit, kohëzgjatja dhe pagesa, përfshirë ndarjen e ngarkesës ndërmjet bashkëudhëheqësve, përcaktohen në marrëveshjen e posaçme, duke respektuar kufijtë e ngarkesës dhe të pagesës të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e UST-së.
 28. Të drejtat mbi pronësinë intelektuale të produkteve shkencore të krijuara në kuadër të bashkëpunimit përcaktohen në marrëveshjen përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronësinë intelektuale dhe me kontributin e palëve në krijimin e tyre.

Neni 13

Sekretariati i dokumentacionit

1. Sekretariati i dokumentacionit administron dhe arkivon të gjithë dosjet e kandidatëve.
2. Çdo dosje ka të depozituar në faqen e parë të gjithë skedën të firmosur dhe me datë nga sekretariati dhe kandidati.
3. Sekretariati i dokumentacionit mban dokumentacionin vjetor të listave të kandidatëve, temave kërkimore në studim, progresin e kandidatëve dhe raportet vjetore të ecurisë së tyre.
4. Në përfundim të përzgjedhjes së kandidatëve, i gjithë dokumentacioni për çdo aplikant, dorëzohet me anë të protokollit në arkivën e UST-se. Sekretariati mban një kopje digjitale të këtij dokumentacioni.
5. Në përfundim të mbrojtjes së temës së doktoraturës së kandidatit/ve, i gjithë dokumentacioni për çdo doktorant, dorëzohet me anë të protokollit në arkivën e UST-se. Sekretariati mban një kopje dixhitale të këtij dokumentacioni.
6. Sekretariati përbëhet nga specialistë/ja e departamentit përgjegjës së programit të doktoraturës.
7. Sekretariati merr pjesë rregullisht në cdo mbledhje të KPD-së, në raportimet periodike të kandidatëve pranë njësisë bazë.

Neni 14

Përgjegjësitë e komisionit *Ad Hoc* të pranimit të kandidatëve në programin e studimit

1. Komisioni *Ad Hoc* ka në dispozicion nga njësia bazë/ kryesore, listën e ekspertëve të fushës/ nënfushave (profesorati UST-së) të cilët vendosin për numrin e ekspertit/ve për vlerësimin e projekt-idesë (kur ka më shumë se një ekspert, merret vlerësimi i mesatarizuar).
2. Sugjerohet të jetë numër i njëjtë ekspert/esh për çdo projekt-ide. Në rast mungese ekspertesh për fushë/ nënfushë mund të jetë dhe një ekspert i përafërt me fushën/nënfushën.
3. Vlerësimi i dosjes dhe vlerësimi i projekt ideo (renditja përfundimtare) bëhet nga Komisioni *Ad Hoc*
4. Komisioni *Ad hoc*, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, mbështetur në propozimin/projektin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, bën renditjen e aplikantëve/kandidatëve, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin përkundrejt kriterëve të përgjithshme dhe/ose specifike/preferenciale të publikuara.

KREU III

HAPJA, ORGANIZIMI DHE PRANIMI NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS

Neni 15

Hapja e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

1. Njësitë bazë/njësitë kryesore të UST-së, mund të paraqesin propozime për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, në rast se plotësojnë kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë por jo vetëm:
 - a) Kanë personel akademik të kategorisë “Profesor” sipas standardeve të kërkuara në fuqi për këto njësi.
 - b) Kanë numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit në përputhje me kuotat e propozuara.
 - c) Ka struktura të posaçme operative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (laboratorë, biblioteka, dhe infrastrukturën e nevojshme, etj).
 - d) Ka burime financiare mbështetëse.
2. Njësia bazë nëpërmjet njësisë kryesore, i paraqet Senatit të UST-së propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës ose për riorganizimin e një programi ekzistues, propozim i cili formulohet sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi.
3. Propozimi duhet të përmbajë:
 - a) Fushat e kërkimit shkencor dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës;
 - b) Të dhëna mbi organizimin e programit;
 - c) Të dhëna mbi programin zhvillimor të studimeve të doktoratës;

- d) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
 - e) Fondet financiare për realizimin e procesit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e vetëfinancimit ose të granteve për projekte kërkimore;
 - f) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, i cili përcaktohet në përputhje me kapacitetet e njësisë bazë;
 - g) Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat përcaktohen nga njësia bazë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
 - h) Personelin akademik, që do të realizojë udhëheqjen e doktorantëve, si edhe nëse në personelin e angazhuar do të përfshihet personel akademik i ftuar, i cili duhet të miratohet paraprakisht nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse;
 - i) Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës, që drejtojnë administrativisht programin e studimit të doktoratës, kur ato janë ndërdisiplinare;
 - j) Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare, nëse kanë pasur.
4. Studimet e doktoratës propozohen dhe organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njësive kryesore dhe UST-së. Këto njësi mund të aplikojnë për financim pranë AKKSHI-it ose pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Në rastet e kandidatëve të cilët janë personel akademik me kohë të plotë, studimet e doktoratës mund të mbështeten nga burimet e brendshme të UST-së. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo dhe të vetëfinancohet.
5. Pas miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i UST-së, aplikimi për hapjen/riorganizimin e programit të studimit të doktoratës, i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për vijimin e procedurave në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
6. Programet e studimit të Doktoratës konsiderohen të miratuara zyrtarisht pas hyrjes në fuqi të Urdhërit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
7. Çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike fushat/nënfushat e kërkimit të programeve të Doktoratës dhe kriteret e përcaktuara nga njësitet bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron.
8. Fushat dhe nënfushat e studimeve të Doktoratës propozohen nga njësitë bazë dhe i përcillen përmes Njësisë Kryesore, e më tej Senatit për miratimin përfundimtar përpara hapjes së thirrjes për pranime në këto programe për çdo vit të ri akademik.

Neni 16

Shpallja e njoftimit për hapjen e pranimeve në ciklin e tretë të studimeve të Doktoratës

1. Pas hapjes/riorganizimit të studimeve të doktoratës dhe/ose miratimit të kuotave për vitin akademik nga MA për programet ekzistuese apo ato të reja të Doktoratës, Rektori i UST-së,

brenda 15 ditëve të punës, nxjerr urdhërin për hapjen e pranimeve në studimet e Doktoratës. Në urdhërin e Rektorit specifikohet hapja e aplikimeve në studimet e Doktoratës në UST si dhe afatet kohore, brenda të cilave do të kryhen këto aplikime.

2. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 5 ditë pune pas daljes së udhërit të Rektorit, përgatit dhe shpall njoftimin për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës, në faqen zyrtare të UST-së dhe ja përcjell në rrugë zyrtare (Hard Copy ose elektronike) njërive bazë përgjegjëse të UST-së dhe për dijeni Koordinatorit të Programit të Studimit.
3. Njoftimi përmban këto informacione:
 - a. Titulli/fusha kryesore e kërkimit të programit të Doktoratës (emërtimi duhet të jetë sipas Udhërit të MA për hapje/riorganizim të shkollës së doktoratës);
 - b. Fushat/nënfushat e studimeve të Doktoratës, sikurse të miratuara zyrtarisht nga organet e UST-së;
 - c. Kuotat e përgjithshme të studimeve të doktoratës në çdo fushë dhe të ndara sipas nënfushave kërkimore (kuotat duhet të jenë sipas përcaktimit në shkresën përcjellëse – Urdhër për njohje dhe zbatim të MA);
 - d. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim
 - e. Afati për paraqitjen e aplikimit (në zbatim të Urdhërit të Rektorit të UST-së për hapjen e aplikimeve).
4. Shpallja e njoftimit/thirrjes për aplikime në programin e Doktoratës me kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të UST-së, si dhe në ambientet e tyre, të paktën një muaj përpara përfundimit të afatit për depozitimin e kërkesave.
5. Kriteret e pranimit nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.

Neni 17

Kërkesat themelore për aplikimin dhe pranimin e kandidatëve

1. Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës, përcakton kriteret e aplikimit lidhur me gjuhën/gjuhët e huaja, mesataren e pranimit, fushën e studimit dhe programet e studimit të cilët pranohen si kandidatë, dokumentet e aplikimit etj dhe i bën ato publike referuar kuadrit ligjor ne fuqi dhe standarteve të Kodit të Cilesisë së Arsimit të Lartë.
2. Për t'u regjistruar në programin e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të përmbushë kriteret të përgjithshme, specifike dhe /ose preferenciale të miratuara dhe të shpallura në njoftimin publik.
3. Kriteret e pranimit dhe skeda e vlerësimit në programin/et e Doktoratës në UST publikohen përpara fillimit të procedurës së pranimit të kandidatëve.
4. Për vlerësimin rendor të kandidatëve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues, njësitë bazë mund të propozojnë edhe kriteret specifike dhe/ose preferenciale si vijon:
 - a) Fusha prioritare të kërkimit;
 - b) Nivele sasior i publikimeve dhe referimeve;
 - c) Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UST-së;
 - d) Preferohet të punojë në fushën/nënfushën përkatëse;

- e) Preferohet të këtë përfunduar programe kualifikime të tjera të ciklit të tretë si Master Ekzekutiv apo ekuivalent me to në drejtime që lidhen me temën e kërkimit;
 - f) Duhet të këtë eksperiencë në mësimdhënie/kërkimore në fushën përkatëse në IAL;
 - g) Duhet të këtë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të këtë botime në fushën përkatëse;
 - h) Si dhe kriteret të tjera, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti.
5. Kriteret specifike dhe/ose preferenciale të miratuara përfshihen në thirrjen për aplikim; ato mund të ndryshohen por jo brenda të njëjtit cikël të plotë studimi.
 6. Aplikanti duhet të përmbushë edhe kriteret specifike nëse ato deklarohen si të detyrueshme.

Neni 18 **Aplikimi i kandidatit**

1. Pas shpalljes së konkursit publik për aplikimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti brenda afatit të përcaktuar në urdhërin e Rektorit të UST-së, aplikon për t'u pranuar në studimet e Doktoratës, me dosjen individuale.
2. Dosja e aplikantit, për programin e studimit të Doktoratës, dorëzohet pranë zyrës së protokollit përkatës të UST-së, e cila ja dorëzon nënshkrimit Kryesore.
3. Dosja individuale duhet të përmbajë të gjitha dokumentat e kërkuara sipas Shtojcës 3 e cila duhet të publikohet në aplikim. Pasi verifikohet i gjithë dokumentacioni nga punonjësi përkatës pritës, një kopje e listës së dokumenteve të dorëzuar i kthehet aplikantit.
4. Dosja duhet të shoqërohet me Projekt-Ideën Kërkimore të hartuar nga kandidati e që duhet të jetë në përputhje me një nga fushat/nënfishat e shpallura në thirrjen/njoftimin për hapjen e pranimeve për vitin akademik përkatës. Projekt-Ideja e paraqitur nga kandidati/aplikanti duhet të hartohet sipas Shtojcës 4 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.
5. Çdo kandidat mund të paraqitet me jo më shumë se një dosje/aplikim/projekt për cdo program të Doktoratës.
6. Brenda 1 (një) jave pas përfundimit të afatit të aplikimeve, njësia kryesore përcjell dosjet e kandidatëve në njësinë bazë përgjegjëse të programit të doktoratës, për vijimin e mëtejshëm të procedurave të parashikuara në këtë rregullore. Njesia Bazë përgjegjëse ja përcjell me shkresë Komisionit *Ad-Hoc*.

Neni 19 **Vlerësimi, renditja dhe përzgjedhja e kandidatëve**

1. Komisioni *Ad Hoc* ka në përbërje të tij anëtarë të njësisë bazë, të njësisë kryesore për programin e studimit që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe ekspertë të listës zyrtare të kapaciteteve akademike të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin për vitin akademik përkatës, fusha e të cilave është në përputhje me fushat e nënfishat kërkimore të shpallura në thirrjen përkatëse.
2. Njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës, brenda 2 (dy) ditë pune nga data e marrjes

së aplikimeve nga ana e drejtuesit të njësise kryesore, i përcjell propozimin për anëtarët përkatës të komisionit “*Ad hoc*” jo më pak se 3 anëtarë, për miratim drejtuesit të njësise kryesore.

3. Drejtuesi i njësise kryesore brenda 2 (dy) ditë pune miraton komisionin “*Ad hoc*” me anëtarët e propozuar nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ai mund të bëjë propozime të argumentuara për ndryshime të anëtarëve në dakortësi me njësinë bazë.
4. Komisioni “*Ad hoc*” është përgjegjës për vlerësimin e dosjes së kandidatëve. Komisioni vlerëson dokumentacionin fizik dhe përmbajtjen e dosjes sipas metodologjisë dhe procedurave të vlerësimit të paracaktuara (Në rast mungese dokumentacioni të detyrueshëm, kandidati skualifikohet automatikisht nga proceset e mëparshme).
5. Njesia bazë i vendos në dispozicion komisionit *Ad Hoc*, listën e ekspertëve të fushës/nënfushave (kategoria Profesor i UST-së).
6. Skema dhe metodologjia e vlerësimit cilësor dhe sasior përkundrejt kriterëve hartohet nga Njësia Bazë/Kryesore dhe i përcillet KPD.
7. Metodologjia dhe skema e vlerësimit me pikë të kandidatëve bëhet transparente dhe publikohet në faqen e internetit të çdo njësie kryesore/UST-së, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.
8. Vlerësimi i përmbajtjes së Projekt Idesë Kërkimore kryhet nga antarët/ekspertët sipas nënfushave (reference lista e eksperteve të ofruar nga njësia bazë). Ky vlerësim kryhet mbi projekt idenë e shkruar dhe prezantimin e tij, të parashikuar në skemën e vlerësimit. Ekspertët paraqesin vlerësim me shkrim për çdo projekt kërkimor të nënfushës së tyre të ekspertizës. Kur vlerësimi është më pak se gjysma e vlerësimit të pikëve maksimale të përmbajtjes së projekt idesë, aplikanti skualifikohet dhe nuk vijon më tej procedurën e vlerësimit.
9. Komisioni *Ad hoc* kryen vlerësimin tërësor dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin në përmbajtje të dosjes së aplikimit dhe vlerësimit të projektit jo më vonë se 10 ditëve pune pas marrjes në dorëzim të dosjeve të aplikimit të kandidatëve.
10. Lista e kandidatëve fitues, të përzgjedhur nga Komisioni *Ad hoc*, miratohet nga drejtuesi i njësise bazë brenda 2 (dy) ditë pune (sekretariati i dokumentacionit njofton kandidatët për renditjen).
11. Kandidati/ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e renditjes së kandidatëve, ka të drejtë të ankimojë me shkrim renditjen në listë sipas vlerësimit të tij/saj, pranë protokollit të njësise kryesore/IAL-së përkatëse.
12. Ankimimet, i përcillen njësise bazë, përmes njësise kryesore, shqyrtohen brenda 5 (pesë) ditëve pune. Kjo e fundit i kthen përgjigje zyrtare të argumentuar ankimuesit, në përputhje me procedurat administrative përkatëse.
13. Brenda 5 (pesë) ditëve, njësia bazë i përcjell drejtuesit të njësise kryesore renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues, dhe e bën publike në website.
14. Brenda 2 (dy) ditëve, njësia bazë përcakton paraprakisht udhëheqësit shkencorë dhe ja përcjell për dijeni njësise kryesore dhe KPD-së.
15. Njësia bazë për secilin nga kandidatët/projekt- idetë fituese u kërkon kandidatëve fitues me udhëheqësit përkatës, të hartojnë Platformën e detajuar kërkimore (Shtojca 6) mbështetur në projekt-idenë fituese të çdo kandidati.

16. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga kjo kërkesë, aplikantët dorëzojnë në Departament Platformën Kërkimore të hartuar sipas formatit të Shtojcës 6 dhe deklarin e udhëheqësit shkencor plotësuar në formatin sipas Shtojcës 7 bashkëngjitur kësaj rregullore.
17. Njësia kryesore përcjell në mënyrë zyrtare listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar në studimet e doktoratës bashkë me udhëheqësit përkatës pranë Rektoratit të UST-së.
18. Lista e kandidatëve fitues shpallet në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse dhe UST-së si dhe në ambientet e saj.
19. Dosjet origjinale të kandidatëve fitues përcillen nga departamenti përgjegjës në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore për regjistrim. Ndërsa dosjet origjinale të jo fituesve kthehen me shkresë në zyrën e protokollit të UST-së. Departamenti përgjegjës duhet të ruaj një kopje të dokumentacionit për të gjithë kandidatët aplikantë.

Neni 20

Regjistrimi i Kandidatëve fitues

1. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore përkatëse të studimeve të Doktoratës, brenda 2 (dy) javëve nga data e shpalljes së listës përfundimtare të kandidatëve fitues.
2. Në rast se një kandidat tërhiqet, ose nuk regjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij, brenda një afati 5 (pesë) ditë regjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare.
3. Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues depozitohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.
4. Në momentin e regjistrimit në programin e studimeve të doktoratës, kandidati pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës, i cili pasqyrohet në regjistrin themeltar.
5. Në rastin kur studenti çrregjistrohet nga një program studimi, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër, i cili kryhet nga sekretaria e njësisë kryesore.
6. Në rastin kur studentit i pezullohet studimi, NIM-i nuk mbyllet dhe mbetet i njëjtë kur studenti e rifillon atë, brenda kuadrit ligjor.
7. Kandidatëve jofitues, me kërkesën e tyre, ju kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, brenda 2 (dy) javëve, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim në zyrën e protokollit të IAL-së.

Neni 21

Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve Doktoratë në UST

1. Çdo njësi bazë në varësi të kapaciteteve pritëse duhet të përcaktojë kuotat e pranimi dhe ja

dërgon njësisë kryesore.

2. Njësia bazë përgjegjëse përcakton kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues për vitin akademik pasardhës brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin specifik të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kuotat i përcillen Senatit Akademik të UST-së për miratim.
3. Çdo njësi kryesore ka detyrim të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.
4. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimi në programin e studimit të Doktoratës publikohen në faqen zyrtare të internetit të cdo njësie kryesore dhe të IAL-së, si dhe në mjediset fizike.

KREU IV

REALIZIMI I STUDIMEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË DOKTORATËS

Neni 22

Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të Doktoratës

1. Kohëzgjatja normale e programit të doktoratës është 3 deri në 5 vite akademike dhe jo më shumë se dyfishi i kohës normale të saj.
2. Kandidatët parashikohet të kryejnë disa veprimtari akademike-kërkimore në përmbushje të kriterëve e standardeve në fuqi.
3. Gjatë vitit të parë të studimeve, kandidatët zhvillojnë këto veprimtari akademike/kërkimore: Përgatitja e një produkti të shkruar sipas Shtojcës 8, raportim viti i parë i studimeve, Përmbledhja e literaturës dhe analiza metodologjike. Kjo veprimtari përgatitore i dorëzohet Departamentit përgjegjës. Raportimi dhe prezantimi bëhet brenda vitit të parë të studimeve ku prezantohet në Departament dhe në praninë e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, ose një përfaqësie të tij. Departamenti ka të drejtë të bëjë sugjerime dhe japë rekomandime të cilat pasqyrohen në vlerësimin e udhëheqësit. Departamenti përgatit raportim dhe me këto sugjerime për cdo student.
Kandidati doktorant ka të drejtë që brenda vitit të parë të studimeve doktorale për rishikimin e strukturës dhe metodologjinë e temës, ti drejtojë kërkesën me shkrim drejtuesit të njësisë bazë, i cili, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve shqyrton dhe i dërgon me shkrim të argumentuar (për miratim), Komisionit të dhënies së gradës shkencore “Doktor” për vendimmarje. Komisioni pranon ose refuzon propozimin e paraqitur dhe shprehet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, me vendim të arsyetuar.
4. Gjatë vitit të dytë të studimeve kandidatët zhvillojnë këto veprimtari kërkimore:
 - a. Konsolidimin e metodologjise, mundet dhe kërkimi i mirëfillt shkencor, zhvillimi i eksperimenteve, sikurse të parashikuara në projektin e platformën kërkimore dhe nën

- drejtimin e udhëheqësit shkencor përkatës.
- b. Veprimtari për reflektimin e rezultateve të përfuara në publikime shkencore si artikuj, prezantime në konferenca, në përmbushje të kriterëve të kërkuara për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.
5. Në përfundim të vitit të dytë kandidatët hartojnë në raport vjetor sipas formatit Shtojca-9 raportim viti i dytë i studimeve; përditësimi dhe konsolidimi i metodologjisë së kërkimit. Kjo veprimtari përgatitore i dorëzohet Departamentit përgjegjës. Raportimi dhe prezantimi bëhet brenda vitit të dytë të studimeve ku prezantohet në Departament dhe në praninë e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, ose një përfaqësie të tij. Departamenti ka të drejtë të bëjë sugjerime dhe japë rekomandime të cilat pasqyrohen në vlerësimin e udhëheqësit. Departamenti përgatit raportim dhe me keto sugjerime për çdo student.
 6. Gjatë vitit të tretë të studimeve, kandidatët kryejnë këto veprimtari:

Raportimin e mbylljes së plotë ose pjesërisht të kërkimit dhe përpunimit të rezultateve, sipas formatit në Shtojcën 10 raportim viti i tretë i studimeve. Kjo veprimtari përgatitore dorëzohet në Departamentin përgjegjës brenda vitit të tretë të studimeve. Departamenti përgatit raportim me ecurinë për çdo student.

7. Në përfundim të vitit të fundit doktoranti kryen:
 - a. Përpilimin dhe shkrimin e dizertacionit të doktoratës.
 - b. Plotësimin e dosjes së dizertacionit me dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore.
 - c. Mbrojtjen e dizertacionit përpara Jurisë përkatëse të ngritur për këtë qëllim.
 - d. Depozitimin e dizertacionit sipas kërkesave në fuqi dhe në këtë rregullore.
8. Në fund të çdo viti të plotë 12 mujor (viti 1 dhe 2) dhe përpara fillimit të procesit të mbrojtjes së dizertacionit, koordinatori i programit të studimit harton një raport vjetor të arritjeve për çdo kandidat, i cili i paraqitet Njesisë Përgjegjëse për Programin dhe Komisionit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.
9. Për kandidatët me kohëzgjatje të studimeve mbi 3 (tre) vite, afatet e shlyerjes së detyrimeve dhe raportimeve të përcaktuara si më lart shtrihen proporcionalisht me kohën e përgjithshme të studimeve, sipas një plani individual të miratuar (sipas legjislacionit në fuqi).

Neni 23

Ndryshimi i udhëheqësit shkencor

1. Udhëheqësi shkencor mund të heqë dorë nga udhëheqja e një kandidati për arsye madhore siç janë ato shëndetësore, pamundësi të diktuar nga kushte familjare apo të tjera të arsyeshme e që gjykojnë se e bëjnë të pamundur ndjekjen dhe plotësimin e detyrimeve ndaj detyrës. Udhëheqësi paraqet kërkesën me shkrim Departamentit përgjegjës për dorëheqje duke argumentuar arsyet dhe dokumentuar, aty ku është e mundur, vërtetësinë e arsyeve të dorëheqjes. Në këto raste departamenti përgjegjës ngren një komision *Ad hoc* për vlerësim dhe merr vendim. Departamenti përgjegjës percjell vendimin e komisionit *Ad hoc* drejtuesit të njesisë kryesore i cili ja percjell komisionit të përhershëm për doktoraturën KPD.

Procedura për miratimin e ndryshimit të udhëheqësit kryhet në të njëjtën hapa dhe afate sikurse ajo e caktimit të udhëheqësve shkencorë në fillim të procesit. Vendimi i bëhet i njohur Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e udhëheqësit të tij shkencor, kur ky/kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e parashikuara. Kërkesa i drejtohet Departamentit përgjegjës të programit. Kërkesat për ndryshimin e udhëheqësit shkencor duhet të mbështetet në prova dokumentare të cilat provojnë qartë mosrespektimin e pikave më lart nga ana e udhëheqësit shkencor ose kandidatit. Në këto raste departamenti përgjegjës ngren një komision *Ad Hoc* për vlerësim dhe merr vendim.

Departamenti përgjegjës përcjell vendimin e komisionit *Ad hoc* drejtuesit të njësisë kryesore i cili ja përcjell Komisionit të Përhershëm për Doktoraturën KPD.

Procedura për miratimin e ndryshimit të udhëheqësit kryhet në të njëjtët hapa dhe afate sikurse ajo e caktimit të udhëheqësve shkencorë në fillim të procesit. Vendimi i bëhet i njohur Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Kur kërkesa e kandidatit për ndryshimin e udhëheqësit miratohet nga Komisioni, njësia bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë një udhëheqës të së njëjtës fushë /nën-fushë të projektit kërkimor ekzistues fitues. Në rast se kjo është e pamundur dhe sjell si pasojë nevojën e ndryshimit të metodologjisë, brenda të njëjtës fushë kërkimore në kuadër të projektit kërkimor të programit të doktoratës të miratuar, dhe të ndjekë procedurën sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës

1. Studenti ka të drejtë:
 - a) të marrë informacion mbi bazën ligjore dhe aktet rregullatore në fushën e Doktoratave;
 - b) të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive të parashikuara në programin e studimeve;
 - c) të shfrytëzojë laboratorët, bibliotekën e fakultetit apo të njësisë përkatëse të kërkimit;
 - d) të shfrytëzojë burimet elektronike të informacionit pranë ambienteve të njësisë bazë/kryesore;
 - e) të aplikojë për të marrë pjesë në mobilitete/periudha kërkimi në institucionet me të cilat UST ka marrëveshje, kur këto mobilitete i dedikohen studentëve të Doktoratës;
 - f) të tërhiqet vullnetarisht nga programi duke paraqitur kërkesën me shkrim në departamentin përgjegjës;
 - g) Të paraqesë shqetësime apo ankime në lidhje me mbarëvajtjen e studimeve që nuk varen prej tij/saj në departamentin përgjegjës;
 - h) Studentit të Doktoratës ti ofrohet përparësi në angazhimin si staf akademik me kohë të pjesshme në fushën përkatëse pranë UST-së kur është e mundur.
2. Studenti ka për detyrë:
 - a) të njohë rregulloren e programeve të studimit të doktoratës dhe bazën ligjore përkatëse

- (VKM, Udhëzime të MA etj);
- b) të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligjet, vendimet, udhëzimet, dhe rregulloret;
 - c) të ndjekë e realizojë deri në fund programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
 - d) të arrijë rezultate të larta në realizimin e programit të studimeve të doktoratës;
 - e) t'i shlyejë në kohën e duhur universitetit (fakultetit), të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe vazhdimi i studimeve në programin e doktoratës;
 - f) të raportojë 3 (tre) herë në njësinë bazë të programit sipas planifikimit të programit të studimit të përcaktuar në këtë rregullore (departament apo grup mësimor shkencor) mbi ecurinë e punës për realizimin e programit;
 - g) të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën;
 - h) të përfundojë punimin brenda afateve të parashikuara.

KREU V

MBROJTJA E DISERTACIONIT DHE DHËNIA E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

Neni 25

Kriteret për mbrojtjen e dizertacionit të Doktoratës

1. Gjatë periudhës së studimeve të Doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë përmbushur kriteret dhe arritur rezultatet e mëposhtme:
 - a) Të ketë përmbushur plotësisht kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi përpara mbrojtjes së dizertacionit (Shtojca 11).
 - b) Të ketë përfunduar dizertacionin, sipas formatit të përcaktuar në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Dizertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UST, në lidhje me Integritetin në Kërkimin Shkencor.
 - c) Të ketë marrë vlerësim pozitiv dhe miratimin nga udhëheqësi përkatës për realizimin e sa më sipër dhe përmbushjen e kriterëve për vijimin e procedurës së mbrojtjes të hartuar sipas Shtojcës 12.
 - d) Të shoqërojë çdo arritje me dokumentacionin evidentues (botimet, referimet, vendimet e departamentit etj) sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi dhe programit të studimit.

Neni 26

Procedura në njësinë përgjegjëse për mbrojtjen e Doktoratës

1. Kërkesa bashkë me listen e dokumentacionit shoqërues për fillimin e procedurës për marrjen e gradës shkencore “Doktor” i drejtohet njësisë kryesore e cila kryen administrimin parësor të dosjes së kandidatit (kriterëve formale) dhe ia percjell njësisë bazë (brenda 15 ditëve) nga data e dorëzimit.

2. Dosja duhet të respektojë kërkesat e formatit të përcaktuar në vijim në këtë rregullore, duke përfshirë përmbledhjen (pdf në CD- me draft disertacionin) si dhe vërtetimin antiplagjaturë.
3. Njësia bazë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune në bashkëpunim me udhëheqësin dhe kandidatin cakton dy relatore të kategorise “Profesor” ku një nga të cilët është personel akademik i njësisë bazë ose brenda njësisë kryesore, ndërsa tjetri është personel akademik i jashtëm i cili mund të jetë nga njësitet Kryesore të tjera të UST të njëjtës fushë kërkimi. Në mungesë të personelit akademik të jashtëm nga UST për specialitetet e fushës së studimit, mund të zgjidhet nga IAL-së të tjera ku ka marrëveshje bashkëpunimi.
4. Relatorët brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, përgatisin relacionin, që dorëzohet tek drejtuesi i njësisë bazë.
5. Drejtuesi i njësisë bazë brenda 5 (pesë) ditëve nga dorëzimi i relacioneve organizon mbledhjen e njësisë bazë ku:
 - a. Kandidati prezanton listën e botimeve dhe referimeve (në përmbushje të kriterëve ligjore në fuqi) dhe më pas relatorët prezantojnë relacionet e tyre.
 - b. Departamenti pasi kalon procedurat për plotësimin e kriterëve ligjore në fuqi, shprehet me vendim me shumicë të thjeshtë vote. Vota kundër duhet të jetë e arsyetuar me shkrim nëse ka. Abstenimi nuk lejohet në procesin e vendimmartjes.
 - c. Nëse njësia bazë e programit të studimit të doktoratës (në mbledhjen e kryer), konstaton se dosja nuk është paraqitur sipas kriterëve të përcaktuara, dosja i kthehet kandidati për plotësimin e të gjitha kërkesave të formatit. Afati për plotësimin e kërkesave të dosjes formatit është brenda 30 (tridhjetë) ditë pune, nga dita e kthimit për plotësim (për rifillim të procedurës fillestare në njësinë bazë).
 - d. Në rast vlerësimi negativ për herë të dytë, kandidati i refuzohet mbrojtja.
 - e. Pas vlerësimit pozitiv nga njësia bazë, doktoranti dorëzon (brenda 5 ditëve pune) disertacionin final në 3 (tre) kopje dhe përmbledhja në 5 (pesë) kopje dhe CD.
 - f. Njësia bazë (brenda 3 ditëve pune) ia përcjell Komisionit të Përhershëm të Doktoraturës, i cili kujdeset për mirëadministrimin e dosjes së kandidati gjatë gjithë procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit në komisionin e përhershëm.
 - g. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për dizertacionin dhe/ ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë dizertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.
 - h. Pas vlerësimit nga njësia bazë, dizertacioni dhe dosja e kandidati i përcillen Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, brenda 30 ditëve. Komisioni nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 ditëve ngre jurinë për vlerësimin e dizertacionit. Juria cakton datën e mbrojtjes së dizertacionit brenda 15 ditëve nga formimi i saj. Dizertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”, i cili brenda 10 ditëve merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 27

Pezullimi dhe ndërprerja e programit të studimeve të doktoratës

1. Nëse doktoranti nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Dekanit kërkon shtyrjen e mbrojtjes për shkaqe të arsyeshme, atëherë mbrojtja konsiderohet e pezulluar. Dekani informon me shkrim Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, Jurinë dhe udhëheqësin shkencor mbi pezullimin e procedurës. Komisioni i përhershëm pasi shqyrton rastet, shprehet me vendim. Përsëritja e procedurës së mbrojtjes është e mundur vetëm 1(një) herë brenda një periudhe nga 3 muaj deri në 6 muaj nga data e pezullimit.
2. Kur udhëheqësi shkencor konstaton se rezultatet e arritura nga doktoranti nuk kanë përmbushur kërkesat dhe objektivat e përcaktuara në programin kërkimor të miratuar, pavarësisht punës së udhëheqësit, dhe që nuk garantojnë vazhdimin e suksesshëm të projektit kërkimor të miratuar në përmbushje të kriterëve akademike të përcaktuara, njofton njësinë bazë për pezullim.
3. Ndërprerja e studimeve të doktoratës, është procesi i ç’regjistrimit nga ky program, në këto raste:
 - a) Kur kandidati në mënyrë të vullnetshme heq dorë nga vazhdimi i studimeve;
 - b) Kur konstatohen sjellje të rënda dhe të përsëritura kundër standardeve të etikës kërkimore, pasi të jenë ndjekur procedurat e përcaktuara në aktet rregullatore në fuqi.
 - c) Kur konstatohet më pas në kohë, se kandidati nuk ka plotësuar kriteret për praninë, të ecurisë në programin përkatës të doktoratës apo parregullsi të tjera të procesit.
 - d) Kalon kohëzgjatja maksimale e përcaktuar për përfundimin e programit të doktoratës dhe nuk ka pasur kërkesë nga kandidati, për shtyrjen ose pezullimin e afatit.
4. Kërkesat me shkrim për ndërprerje të studimeve të ardhura nga kandidati dhe/ose udhëheqësi shkencor merren në shqyrtim nga Drejtuesi i njësisë bazë. Njësia bazë përkatëse, ngre një komision *Ad-hoc* për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për ndërprerjen e këtij programi studimi, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim komisioni *Ad-hoc* përcjell vlerësimin e tij tek Drejtuesi i njësisë bazë, i cili ja përcjell drejtuesit të njësisë kryesore. Drejtuesi i njësisë kryesore ja përcjell vendimin për miratim, Komisionit të përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor”, të cilët marrin vendimin përfundimtar me shumicë të thjeshtë votash.
5. Në rastet e vendimeve për ndërprerje të studimeve nga organe më të larta kolegjiale të UST-së, drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe Komisionin e Doktoratës dhe ja përcjell vendimin për zbatim sekretarisë mësimore.

Neni 28

Rregullat për paraqitjen e disertacionit

1. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe. Doktoranti dorëzon një përmbledhje (jo më pak se 20 faqe) e cila hartohet në shqip dhe në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik (pdf). Në

marrëveshje me udhëheqësin/it disertanti mund të hartojë disertacionin edhe në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*). Përpara dorëzimit disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.

2. Disertacioni duhet të plotësojë kërkesat e paraqitjes, formatimit dhe vëllimit sipas Shtojcës 14, bashkëlidhur kësaj rregullore.

Neni 29

Regjistrimi i gradës Doktor

1. Grada shkencore “Doktor” regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe në regjistrin e brendshëm në Sekretariatit e dokumetacionit të njësisë bazë.
2. Diploma e gradës shkencore “Doktor”, sipas formës dhe elementëve të miratuar nga Senati Akademik, lëshohet nga Universiteti i Sporteve, Tiranë dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit përkatës dhe Rektori, si rregull, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit zyrtar të numrit të regjistrimit nga AKKSHI.
3. Regjistri i brendshëm i Gradës Shkencore “Doktor”, përmban të dhënat e mëposhtme:
 - a) Numri rendor;
 - b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet grada shkencore "Doktor";
 - c) Gjinia;
 - d) Datëlindja;
 - e) Shtetësia;
 - f) Emërtimi i institucionit/ve të arsimit të lartë ku personi ka kryer studimet e doktoratës;
 - g) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë, i njësisë kryesore dhe/ose njësisë bazë që ka dhënë gradën shkencore "Doktor";
 - h) Forma e studimit;
 - i) Numri i matricullimit;
 - j) Data e regjistrimit në programin e studimit të Doktoratës;
 - k) Numri dhe data e Vendimit të jurisë për dhënien e gradës shkencore "Doktor";
 - l) Data e regjistrimit në regjistrin për Gradën Shkencore, pranë AKKSHI-t;
 - m) Tema e disertacionit;
 - n) Fusha e studimit dhe vlerësimi.

Neni 30

Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës dhe pezullimi

1. Kohëzgjatja normale e programit të doktoratës është 3 deri në 5 vite akademike dhe jo më shumë se dyfishi i kohës normale të saj.
2. Për arsye të përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësi etj) kandidati mund t'i kërkojë njësisë bazë përkatëse shtyrje të afatit të përfundimit të studimeve të doktoratës duke paraqitur dhe

dokumentuar edhe arsyet e kësaj shtyrjeje. Në çdo rast, shtyrja e afatit të përfundimit të studimeve të doktoratës nuk mund të tejkalojë afatet ligjore maksimale për përfundimin e programit të studimit.

3. Periudha e pezullimit (shtyrjes) të afatit përlogaritet në afatin maksimal të përcaktuar nga ligji, për përfundimin e programit të doktoratës.
4. Në çdo rast, kërkesa për shtyrje/pezullim, duhet të jetë e miratuar nga udhëheqësi shkencor i doktoratës. Njësia bazë përkatëse, me kërkesë të udhëheqësit shkencor, ngre një komision *Ad-hoc* për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për shtyrjen/pezullimin e programit të studimit, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim, përmes drejtuesit të njësisë bazë, komisioni *Ad-hoc* përcjell vendimin së bashku me dokumentacionin justifikues tek Drejtuesi i njësisë kryesore, i cili merr vendimin përfundimtar.

Neni 31

Veçoritë e organizimit të programeve të përbashkëta të doktoratës

1. Universiteti i Sporteve të Tiranës mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një ose më shumë universitete të tjera (vendase ose të huaja), në bazë marrëveshjes, duke pasur parasysh si më poshtë:
 - a) Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse;
 - b) Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
 - c) Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet teza e doktoratës apo pjesë të saj, përcaktuar në marrëveshjen midis universiteteve, nëse njëri nga universitetet është i huaj;
 - d) Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi kryesore ku është zhvilluar tema;
 - e) Secili universitet i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi gradën “Doktor” ose të barasvlershëm me të, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktrate në bashkëpunim me universitetin”.
2. Rregullimi i detajuar i këtyre programeve bëhet me rregullore të përbashkëta të posaçme, mbështetur në rregulloret përkatëse të institucioneve partnere.

Neni 32

Veçoritë e organizimit të programeve ndërdisiplinore të doktoratës

1. Fakultetet e Universitetit të Sporteve të Tiranës mund të organizojnë programe ndërdisiplinore të studimit të doktoratës me një ose më shumë njësi kryesore të tjera të UST- së, në bazë marrëveshjes, duke pasur parasysh si më poshtë:
 - a) Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të

- alternuara në secilin prej fakulteteve përkatës;
- b) Fusha e kërkimit të jetë e përafërt;
 - c) Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilën njësi kryesore për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
 - d) Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi kryesore;
 - e) Secila njësi kryesore i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi titullin “Doktor” ose të barasvlershëm me të, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktorate në bashkëpunim me Fakultetin”.

Neni 33

Mbarëvajtja e Programit të Doktoratës

1. Sekretariati i dokumentacionit të programit të studimit mban dhe ruan të gjitha të dhënat që lidhen me kandidatët, udhëheqësit shkencorë, temat/projektet kërkimore që zhvillohen në kuadër të studimeve të programit në të gjitha vitet, raportet vjetore të progresit individual të kandidatëve dhe të gjithë dokumentacionit të kërkuar e që dëshmojnë pranimin, përparimin e kandidatëve gjatë studimeve dhe mbrojtjen e marrjen e gradës shkencore “Doktor”.
2. Bazuar në raportet vjetore individuale të kandidatëve dhe të udhëheqësve shkencorë, drejtuesi i njësisë bazë përgatit në fund të çdo viti akademik, një Relacion të Përgjithshëm të programit ku përmbahen të dhënat e arritjeve të kandidatëve. Ky relacion, i formatuar sipas Shtojcës 14 bashkëngjitur kësaj rregulloreje, i paraqitet njësisë kryesore, Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.
3. Raporti Vjetor i Programit të Doktoratës i përcillet Drejtuesit Kryesor, ndërsa ky i fundit, Komisionit të Përhershëm.

Neni 34

Mbi etikën e kërkimit

1. Çdo disertacion duhet të reflektojë rregullat, që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në përputhje me Vendimin nr. 831, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor”.
2. Kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij dhe se ka respektuar rregullat e mënjanimi të plagjaturës në kërkim Shtojca 5.
3. Të gjitha kërkimet shkencore që kryhen në njerëz apo kafshë duhet të jenë në përputhje me dispozitat ndërkombëtare dhe kombëtare në fuqi për këto kërkime. Kjo përfshin dhe marrjen e pëlqimit përmes nënshkrimit individual të subjekteve humane që përfshihen në kërkim, apo të kujdestarëve të tyre kur janë të mitur apo të paaftë ta bëjnë këtë. Për këto raste merret

paraprkisht miratimi nga Këshilli i Etikës së UST dhe nga çdo institucion tjetër i përfshirë kur kërkimi kryhet në një institucion tjetër apo në bashkëpunim.

4. Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme.
5. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur Dekanit për veprime të mëtejshme.
6. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera ligjore të aplikueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.

Neni 35

Financimi

Vlera financiare e doktoratës si rregull financohet nga kandidati por mund të mbulohet pjesërisht apo plotësisht edhe nga fondet për kërkim shkencor të IAL-së, nga grantet e punës kërkimore- shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe/ose nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike.

Neni 36

Dispozita kalimtare

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët që regjistrohen në programet e doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj.

Studentët që kanë filluar programin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, vazhdojnë studimet në përputhje me rregullat dhe aktet që kanë qënë në fuqi në momentin e regjistrimit të tyre si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Dispozitat e kësaj rregulloreje që lidhen me bashkëudhëheqjen në programet e studimit të doktoratës, mund të zbatohen edhe për studentët që kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të saj, me kërkesë të studentit ose udhëheqësit shkencor dhe me miratimin e organit përgjegjës të njësisë bazë dhe të organit drejtues të institucionit.

Neni 37

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Shtojcat në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
 - Shtojca 1: Baza ligjore e programeve të studimit të Doktoratës;
 - Shtojca 2: Kriteret e përgjithshme të pranimit;

- Shtojca 3: Dokumentacioni i aplikimit;
- Shtojca 4: Formular për propozimin e temës kërkimore shkencore të kandidatit për student; në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës;
- Shtojca 5: Formati i deklarimit antiplagjaturë;
- Shtojca 6: Formular për propozimin e platformës kërkimore shkencore të kandidatit për student në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës;
- Shtojca 7: Formati i deklarimit të udhëheqësit shkencor;
- Shtojca 8: Formati i raportimit 1, viti I;
- Shtojca 9: Formati i raportimit 2, viti II;
- Shtojca 10: Formati i raportimit 3, viti III;
- Shtojca 11: Kriteret e arritjeve përpara mbrojtjes;
- Shtojca 12: Formati i vlerësimit të kandidatit nga udhëheqësit shkencor;
- Shtojca 13: Rregulla të paraqitjes, formatimit dhe vëllimit të dizertacionit;
- Shtojca 14: Formati i raportimit vjetor të programit të studimit të Doktoratës.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASA

